



Nr. _____

Datë, ___/___/_____

KONTRATE BASHKEPUNIMI

Kjo kontratë lidhet mes VAS TOUR, i quajtur më poshtë Operatori Turistik, dhe _____ e cilësuar më poshtë si agjencia.

Operatori turistik: VAS TOUR, me nr. NIPT J62001503J me përfaqësues ligjor Enver Mehmeti, dhe adresë: Rr.Ibrahim Rugova, Nd.28, H.8, me nr. Tel: +355 422 53342, Cel: +355 6940 76615, email:info@vas.al, web: www.vas.al

dhe

Agjencia Turistike _____ me nr. NIPT _____ me përfaqësues ligjor _____, dhe adresë: _____, dhe nr tel: +355 _____, Cel: +355 _____, email: _____.

Duke parashtruar se:

1. Vas Tour si i pari operator turistik në Shqipëri i cili ofron paketa turistike gjatë gjithë vitit, do të ofrojë për agjencinë partnere këto shërbime:
2. *Hotele, Fluturime, Paketa turistike gjatë gjithë vitit, Pushime me Charter, Evente sportive, Transferta, Makina me qira, Organizim konferencash e aktiviteteve të ndryshme, Programe individuale dhe për grupe.*
3. Këto produkte ofrohen për tregun shqiptar nëpërmjet programit B2B për agjencitë anëtare, në faqen e internetit; www.vas.al
4. Agjencitë që dëshirojnë të përdorin këto produkte duhet të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit me Vas Tour si dhe të zbatojnë të drejtat dhe detyrimeve që burojnë nga kjo marrëveshje.
5. Agjencia duhet të nënshkruajë këtë marrëveshje, si dhe të plotësojë dokumentacionin mbështetës për hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Agjencia duhet të dorëzojë pranë zyrave të operatorit turistik,
 - a) Kontratën e bashkëpunimit të firmosur,
 - b) Çertifikatë regjistrimi të agjencisë (NIPT), si dhe Logon e saj,
 - c) Kopje të dokumentit identifikues të administratorit të agjencisë,
 - d) Numër telefoni të zyrës, adresën e plotë dhe një numër celulari.
6. Agjencitë në momentin e regjistrimit përfitojnë *çmime speciale* si partnerë biznesi.

7. Agjencia do të mbajë përgjegjësi të plotë për rezervimin që kryen, për hotelin e zgjedhur nga klienti, destinacionin e zgjedhur nga klienti, apo për çdo të dhënë tjetër të hedhur gabim në rezervim.
8. Agjencia do të mbajë operatorin të mbrojtur nga ankesat e klientëve të saj për çdo gabim apo pasaktësi të kryer nga agjencia.

Palët bien dakord si më poshtë;

OBJEKTI I KONTRATES

Qëllimi i kësaj kontrate është ofrimi i të gjithë shërbimeve të përmendura në pikën 2, për agjencitë turistike të cilat regjistrohen si përdorues të ligjshëm të faqes www.vas.al, sipas kushteve dhe detyrimeve të vendosura.

MËNYRA E REGJISTRIMIT

Mundësitë e regjistrimit si agjenci anëtare janë: a) nëpërmjet aplikimit direkt në faqen e internetit, www.vas.al ose b) duke dërguar një kërkesë në adresën info@vas.al

Në momentin e dorëzimit të dokumenteve të kërkuara, agjencisë do ti jepet një emër përdorimi dhe fjalëkalimi fillestar për ti mundësuar të drejtën e hyrjes në faqen e internetit si agjenci, si dhe për të përfutur çmimet speciale si agjenci anëtare.

Llogaria e hapur për agjencinë, nuk duhet të përdoret dhe as të transferohet në një palë të tretë. Për arsye sigurie operatori turistik ka të drejtë edhe të ndryshojë fjalëkalimin e llogarisë së agjencisë. Agjencia duhet të njoftojë operatorin turistik në rast largimi nga puna të stafit të saj i cili ka të drejtë përdorimi në sistem.

MËNYRAT E PAGESËS

Për të gjithë shërbimet që agjencia dëshiron të rezervojë dhe të konfirmojë menjëherë rezervimin i duhet të kryejë menjëherë pagesën, në një nga mënyrat e poshtëpërmendura, në mënyrë që të krijojë dokumentet e nevojshme të rezervimit. Në të kundërt rezervimi i agjencisë do të jetë në statusin ***"I pakonfirmuar"***.

Për shërbimet që do ti ofrohen, agjencia mund të vendosë të paguajë në një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) Pagesë me Kartë Krediti / Debiti
- b) Pagesë me transfertë bankare
- c) Pagesë me para në dorë (shoqëruar me faturë tatimore (TVSH)).
- d) Pagesë FIDO. (Agjencia depoziton shumën fillestare prej 500 Euro, në llogarinë e Albtours D –Vas Tour Operatore, e cila do të konvertohet në kredite të cilat mundësojnë kryerjen e rezervimeve online menjëherë)

Detajet e Bankave:

INTESA SAN PAOLO BANK

- Emri: Albtours D – Vas Tour Operatore
- Nr. Llogarie: 20074835308
- Monedha: Eur
- IBAN: AL72208110080000020074835308
- SWIFT: USALALTR

BANKA KOMBETARE TREGTARE

- Emri: Albtours D – Vas Tour Operatore
- Nr. Llogarie: 404015925CLPRCFEURBY
- Monedha: Eur
- IBAN: AL9520512046015925CLPRCFEURB
- SWIFT: NCBAALTXXXX

RAIFFEISEN BANK

- Emri: Albtours D – Vas Tour Operatore
- Nr. Llogarie: 0120003927
- Monedha: Eur
- IBAN: AL51202110130000000120003927
- SWIFT: SGSBALTXXX

Gjatë rezervimit në faqen e internetit agjencisë i jepen disa mundësi pagese nëse rezervimi nuk është brenda afatit të anulimit.

Mundësia e parë është me **kartë Krediti ose Debiti**. Më këtë mënyrë ju paguani menjëherë dhe në momentin e konfirmimit ju keni te drejtë të krijoni dokumentet e rezervimit, (Voucher për hotel, biletat elektronike, si dhe të shikoni faturën tuaj të rezervimit).

Mundësia e dytë është **“Me para në dorë”** dhe **“Në pritje”**: Nëse itinerari juaj nuk është në periudhën e anulimit ju do t’ju shfaqen këto mundësi pagese. Ju mund të kryeni rezervimin duke zgjedhur një nga këto mundësi por rezervimi juaj do të qëndrojë në statusin **“I ri”** deri në momentin e konfirmimit të pagesës. Limiti i krediteve tuaja nuk do të ndryshojë nëse keni zgjedhur këto mundësi. Ju mund të paraqiteni në zyrat e Operatorit Turistik për të paguar faturën e rezervimit tuaj apo të kryeni një transfertë bankare. Në këtë moment në sistemin tuaj ju mund konfirmoni itinerarin tuaj dhe të krijoni dokumentet e konfirmimit të rezervimit.

Mundësia e përdorimit të **krediteve**: Nëse agjencia zgjedh këtë mundësi pagimi rezervimi juaj do të konfirmohet dhe dokumentohet menjëherë. Shuma e rezervimit do të zbritet nga depozita (FIDO) juaj.

PROCEDURA E REZERVIMIT

Nëpërmjet sistemit www.vas.al agjencia mund të kryejë rezervime, ti konfirmojë duke kryer pagesën, si dhe të lëshojë gjithë dokumentacionin për itinerarin e përzgjedhur.

Agjencia mban përgjegjësi të plotë për rezervimin që ka kryer. Numri i persona për cdo dhomë në hotel është i përcaktuar në momentin e shënimit të të dhënave gjatë rezervimit; Gjatë rezervimit ju duhet të cilësoni saktë numrin e personave që udhëtojnë, moshën e saktë të fëmijës në momentin e udhëtimit, pasi politikat e furnitorëve variojnë sipas moshës së fëmijës. Shërbimet e ofruara të çdo hoteli ndryshojnë nga një shtet në tjetrin në varësi të rregullave përkatëse.

Informacioni akomodimit është i siguar nga faqet zyrtare të hoteleve dhe çdo pasaktësi informacioni, duke përfshirë dhe fotografitë nuk është përgjegjësi e Operatorit Turistik. Hotelet mund të ndryshojnë emrin zyrtar të tyre në cdo kohë dhe kjo nuk konsiston në ndryshimin e hotelit apo modifikimin e rezervimit.

Nëse hoteli kërkon kosto shtesë për krevate ekstra, vakte ose shërbime të tjera, këto do të paguhet sipas mënyrës së kërkuar nga furnitori.

Çdo natë ekstra e shtuar pas konfirmimit të rezervimit do të konsistojë në kosto extra.

- Rezervimet e hoteleve

Në momentin e konfirmimit të rezervimit të një hoteli, dhe kryerjes së pagesës agjencia ka mundësi të krijojë Voucher (*dokumenti i konfirmimit të hotelit*). Voucher i lëshuar i cili tregon numrin e rezervimit dhe është detyrues për paraqitjen e klientit në hotel, do të këtë të pasqyruar të dhënat e agjencisë dhe logon e saj, si dhe do të tregojë emrin e operatorit turistik i cili ka kryer rezervimin final shoqëruar me numrin e emergjencës së tij. Klienti do të përfitojë **vetëm** ato shërbime që janë shënuar në voucher.

Furnitorët mund të refuzojnë pranimin e rezervimit në rast se informacioni i dërguar për prenotim nuk është i plotë.

- Rezervimet e fluturimeve

Agjencia mban përgjegjësi për rezervimet e fluturimeve. Për çdo ndryshim në detajet e fluturimit nga agjencia, pas konfirmimit të rezervimit, duhet menjëherë të njoftojë operatorin. Agjencia është përgjegjëse për informimin e klientëve për dokumentacionin e kërkuar në udhëtim (vlefshmërinë e pasaportave, vizat etj). Në çdo rast agjencia mund të konsultohet me operatorin turistik.

Operatori turistik nuk mban asnjë përgjegjësi për mos ofrimin e shërbimeve në rast të situatave të jashtëzakonshme. (forca madhore).

Gjithashtu operatori nuk mban asnjë përgjegjësi për:

Incidente që mund të ndodhin klientëve të agjencisë me bagazhet, humbje të fluturimeve për shkak të vonësive të klientit, grevave, kushteve klimatike, ndryshimeve që mund të ndodhin gjatë tranzitit apo ndonjë situatë tjetër jashtë kontrollit të operatorit.

AFATET

Kushte të përgjithshme

Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai përpara 21 (njëzetë e një) ditë ose më shumë ditë përpara udhëtimit, klientit i kthehet shuma e plotë e paguar në emër të agjencisë. Nëse përpara anulimit është bërë ndonjë shpenzim, ky shpenzim do të zbritet nga shuma që do të marrë klienti. Shpenzimet përfshijnë edhe komisionin bankar në rastin e pagesës me kartë krediti ose debiti.

Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai 10 (dhjetë) deri 20 (njëzetë) ditë përpara udhëtimit, klienti ka të drejtë të rimbursohet deri në 50% të shumës së paguar për rezervimin. Klienti do të paguajë shpenzimet e transfertës dhe shpenzime administrative që mund të jenë kryer për shërbimin ndaj tij. Shpenzimet përfshijnë edhe komisionin bankar në rastin e pagesës me kartë krediti ose debiti.

Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai 4 (katër) deri 9 (nëntë) ditë përpara udhëtimit, klienti ka të drejtë të rimbursohet deri në 30% të shumës së paguar për rezervimin. Klienti do të paguajë shpenzimet e transfertës dhe shpenzime administrative që mund të jenë kryer për shërbimin ndaj tij. Shpenzimet përfshijnë edhe komisionin bankar në rastin e pagesës me kartë krediti ose debiti.

Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai në më pak se 3 (tre) ditë përpara udhëtimit, klienti nuk ka të drejtë të rimbursohet nga agjencia.

Nëse klienti nuk paraqitet ose largohet nga udhëtimi më përpara datës së parashikuar nga agjencia, klienti nuk ka të drejtë të rimburohet nga agjencia

Transferimet (për paketat e udhëtimit)

Konsumatorët kanë të drejtën të transferojnë paketën e udhëtimit tek një person tjetër. Në një rast të tillë, agjencia ka detyrimin të njoftojë klientët e saj për afatet e ushtrimit të kësaj të drejte. Vas Tour duhet të njoftohet për çdo kërkesë për transferim të paktën 15 ditë para përpara nisjes së udhëtimit. Agjencia është *përgjegjëse*, tek Vas Tour për pagesën e çdo kosto shtesë, që mund të rrjedhë nga ky transferim. Shuma që do të paguhet varion në varësi të kostove që vendosen nga furnitorët përkatës.

Anulimet

Në momentin e rezervimit të çdo produkti ju do të njoftoheni dhe për afatin e anulimit si dhe kostot që i detyroheni Vas Tour në rast anulimesh. Çdo kërkesë e tillë që do të vijë nga agjencia do të trajtohet në përputhje me kushtet e vendosura në momentin e rezervimit.

Në rast se gjatë kërkimit të një produkti agjencia nuk është e qartë për afatet e anulimeve ose ato nuk janë të specifikuar, është përgjegjësi e agjencisë të kërkojë sqarim nga Vas Tour përpara se të procedojë me rezervimin.

Procedura e Rimbursimit

Kërkesat për rimbursim do të konsiderohen në përputhje me politikat e anulimit dhe afatet të vendosura nga Vas Tour.

Në rast anulim paketash turistike nga ana e Vas Tour (në rast se nuk plotësohet numri i parashikuar, ose në situata të jashtëzakonshme), agjencia do të njoftohet për procedurën e rimbursimit në momentin e njoftimit të anulimit. Në raste të tilla agjencisë (ose klientëve të saj) do t'u rimburohet e plotë shuma që kanë paguar.

Kërkesat për rimbursim në rast anulimi duhet paraqiten pranë zyrave të Vas Tour, në formë të shkruar, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të anulimit. Kërkesa do të shoqërohet me dokumentacionin provues dhe, do t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.

Ndryshime të tjera në rezervim

Çdo kërkesë e agjencisë lidhur me rezervimet e saj do të merret menjëherë në konsideratë nga operatori turistik. Zgjidhja e kërkesës do të jetë gjithmonë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve brenda kësaj marrëveshjeje. Pavarësisht këtyre operatori do të përpiqet apo sugjerojë mënyrat më të mira për zgjidhjen e kërkesës.

Kërkesat për ndryshim në rezervim duhet të kryhen brenda afateve dhe detyrimeve të vendosura nga furnitori në momentin e rezervimit. Për çdo ndryshim pas këtij afati do të aplikohen tarifet shtesë në varësi të politikave të ndryshimeve të përcaktuara në sistem.

ANKESAT

Në rast ankese agjencia duhet të drejtohet operatorit brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të shërbimit. Vas Tour është i detyruar të kthejë një përgjigje brenda 20 ditëve pune nga data e marrjes së ankesës.

HYRJA NË FUQI

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe të plotësimit të gjithë dokumentacionit mbështetës të kërkuar nga operatori turistik dhe, ka një afat një vjeçar. Kontrata mund të rinovohet me te njëjtin afat automatikisht, nëse asnjëra nga palët nuk njofton me shkrim palën tjetër 30 ditë para përfundimit të afatit të kontratës.

Palët në marrëveshje bien dakord të plotësojnë kushte dhe detyrimet e nënshkruara.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet mes palëve lidhur me sa është rënë dakord, nëse nuk zgjidhen mes palëve, do të shqyrtohen sipas legjislacionit shqiptar në gjykatat shqiptare.

OPERATORI TURISTIK

AGJENCIA

VAS TOUR